

## SHTESË E KUSHTEVE TË BLERJES TEK MLZBB PËR NJËSITË E SHITJES RIME

### 1. FUSHA & ZBATIMI

- 1.1 Marrëveshja e Licencës së Zgjidhjes BlackBerry (“MLZBB”) zbatohet për të gjithë distributorët (pa dhe me pagesë) përmes njësisë të shitjes RIME. Kjo Shtesë vendos afate dhe kushte shtesë blerjeje (“Kushte Blerjeje”) që zbatohen për çdo blerje nga një Ofertë për të cilën RIME është tregtar i dokumenteve për ruajtje (ose agjent i tregtarit të dokumenteve për ruajtje) për transaksionin (së bashku “Blerjet” dhe akti i bërjes së një blerjeje “Blerje” ose “Blerë”). RIME do të thotë Shoqëria *Research In Motion E-Commerce S.à.r.l., Research In Motion E-Commerce Corporation, Research In Motion E-Commerce Inc.*, ose një shoqëri tjetër filial i RIM që identifikohet te <http://www.blackberry.com/legal/rime> si distributor Ofertash në juridiksionin Tuaj. Referimi tek ‘*BlackBerry Commerce*’ në një njësi shitjeje RIME ose në komunikimet që kanë lidhje me të, është, për qëllime të këtyre Kushteve të Blerjes, një referim tek RIME. Cdo fjalë që fillon me gërmë të madhe në këtë Shtesë, që nuk është përkufizuar në këtë Shtesë, do të ketë kuptimin që i është dhënë në MLZBB. Nëse nuk keni ende një kopje të MLZBB në juridiksionin Tuaj, ajo mund të gjendet tek [www.blackberry.com/legal](http://www.blackberry.com/legal).
- 1.2 KJO MARRËVESHJE BËHET NJË MARRËVESHJE DETYRUESE NDËRMIJET JUSH, BLERËSIT (REFERIMET TEK “JU” OSE “JUAI”) INTERPRETOHEN NË MËNYRËN E DUHUR), DHE RIME KUR JENI DAKORD ME KËTË SHTESË DUKE KLIKUAR ‘UNË PRANOJ’ MË POSHTË, DHE ZBATOHET TEK TË GJITHA BLERJET E MËPASME DERI NË MOMENTIN KUR RIME TREGON SE ZBATOHEN KUSHTE TË NDRYSHME PËR NJË BLERJE TË ARDHSHME. NËSE NUK JENI GATI TË BINI DAKORD ME KËTË SHTESË (OSE ME CDO SHTESË NË TË ARDHMEN NË LIDHJE ME BLERJET NDAJ TË CILAVE KËTO SHTESA DO TË ZBATOHEN), JU NUK U LEJOHET TË BËNI NJË BLERJE. JU LUTEMI PRINTONI NJË KOPJE TË KËTYRE KUSHTEVE TË BLERJES (TË CILAT MUND TË SHIHEN TEK [www.blackberry.com/legal](http://www.blackberry.com/legal)) SI DOKUMENTE PËR RUAJTJE.
- 1.3 DUKE RËNË DAKORD ME KËTO KUSHTE BLERJEJE, JU SIGURONI DHE GARANTONI RIME SE JU E KENI ARRITUR MOSHËN E TË QENIT MADHOR SIPAS LIGJEVE TË JURIDIKSIONIT TUAJ.
- 1.4 Një porosi e dhënë nga Ju përbën ofertën Tuaj për RIME për të blerë një Ofertë sipas kushteve të MLZBB siç parashikohet e ndryshuar në këtë Shtesë; ajo i nënshtrohet Pranimi të RIME. Pranimi i një kontrate për një Blerje të veçantë ndodh kur, cilado ndodh më herët, (a) RIME pranon pagesën Tuaj për Blerjen; dhe (b) RIME dërgon urdhër konfirmimin tek Ju, nëpërmjet të cilit Ju lejon të shkarkoni ose të aksesoni Ofertën. Kushtet e Blerjes përbëjnë një kontratë më vete ndërmjet Jush dhe RIME për çdo Ofertë, dhe çdo difekt ose mungesë funksionimi në ose tek çdo Ofertë nuk Ju jep të drejtë të anuloni Blerjet Tuaja për Ofertat e tjera, pavarësisht nëse janë porositur në të njëjtën kohë ose jo.
- 1.5 Ju jeni në dijeni se RIME vepron si agjent i Shitësit të Ofertës për kryerjen e Blerjes, si dhe, përveç Produkteve *In-App*, edhe për dërgimin e Ofertës tek Ju. Dërgesa nga RIME e Ofertave do të bëhet duke ju mundësuar Ju të shkarkoni çdo Ofertë tek Programi i Aparatit Tuaj BlackBerry ose të keni akses tek çdo Ofertë përmes Programit të Aparatit Tuaj BlackBerry. Gjithashtu Ju jeni në dijeni se Produktet *In-App* nuk gjenden në serverat RIME dhe as shpërndahen nga ndonjë njësi shitjeje RIME; është Shitësi Ofrues i këtyre Produkteve *In-App*, dhe jo RIME, që është përgjegjës të përmbushë dërgimin e Produkteve *In-App* tek Ju.
- 1.6 RIME mund, nën diskrecionin e vet RIME, të refuzojë porosinë Tuaj (pa asnjë detyrim/përgjegjësi). Nëse do të ndodhë kjo, asnjë pagesë nuk do t’u mbahet ose zbritet nga llogaria e autorizuar prej Jush për të bërë pagesën, ose RIME do t’u kthejë çdo pagesë të mëparshme që mund të keni bërë për atë Ofertë.

- 1.7 Ju jeni dakord dhe siguroni se Ju bëni Blerjet vetëm për përdorimin Tuaj personal dhe jo për shpërndarje të mëtejshme.
- 1.8 Në kontekstin e Blerjes, e drejta e parashikuar në MLZBB për të bërë përditësime, modifikime, dhe përshtatje tek një Njësi shitjeje RIME pa një njoftim të mëparshëm passjell ndryshime të çmimeve dhe të kushteve të blerjes, duke përfshirë kushtet e Njësive të shitjes RIME dhe transaksioneve nga RIME për procesimin e Produktit In-App duke përdorur Shërbimin e Pagesës BlackBerry, me kusht që këto ndryshime do zbatohen vetëm për porositë që nuk janë Pranuar në kohën e ndryshimit. Nuk ka çmim për mbrojtje, dhe nëse Ju zgjidhni të vazhdoni me një porosi që nuk është Pranuar në kohën e ndryshimit, Ju jeni në dijeni se Oferta do t'ju sigurohet në përputhje me përshkrimin e modifikuar ose të ndryshuar ose me çmimit të korigjuar dhe do t'ju nënshtrohet kushteve të rishikuara të blerjes.
- 1.9 RIME mund të mbajë në ruajtje dokumentacionin në lidhje me të gjitha transaksionet për një periudhë të dhënë, sic mund të lejohet sipas ligjeve të zbatueshme. Ju duhet të printoni një kopje të të gjitha dokumentave në lidhje me Blerjet Tuaja nëpërmjet një Njësie Shitjeje RIME. RIME mund, por nuk arrin të garantojë, që RIME do të jetë i aftë që t'ju pajisë me kopje të këtyre dokumentave sipas kërkesës Suaj me shkrim.

## **2. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË**

**2.1** RIME rezervon të drejtën që të verifikojë Vendndodhjen Tuaj dhe Informacionin për Pagesat (të përcaktuar më poshtë) dhe të ndër marrë hapa të tjera për të bërë të vlefshëm identifikimin Tuaj ose për të zbuluar mashtrime apo vjedhje dhe për t'ju mbrojtur ndaj tyre.

**2.2** Ju jeni përgjegjës për të siguruar që cdo fjalëkalim që Ju përdorni për të hyrë apo për të përdorur një Njësi Shitjeje RIME dhe/ose për të bërë pagesa për Ofertat të jetë i sigurt dhe përcaktimet e MLZBBsë në lidhje me fjalëkalimet zbatohen ndaj të përdorimit të tyre prej Jush në lidhje me kryerjen e Blerjeve. Nga momenti që Ju fusni fjalëkalimin Tuaj, nuk do t'ju kërkohet që ta rifusni këtë fjalëkalim gjatë periudhës së gatshme të fjalëkalimit të treguar në përcaktimet e Opsioneve Tuaja të Pagesës. Në rast se Ju dëshironi që t'ju kërkohet fjalëkalimi Juaj për cdo Blerje që bëni, Ju duhet të ndryshoni përcaktimin e fjalëkalimit të gatshëm në Opsionet Tuaja të Pagesës.

**2.3** Ofertat që vihen në dispozicion me anë të një Njësie Shitjeje RIME janë të menduara për individë me kapacitetin dhe aftësinë e nevojshme për të miratuar ligjërisht dhënien e informacionit të kërkuar dhe për të lidhur një marrëveshje detyruese dhe të zbatueshme. Ju bini dakort që të jeni financiarisht dhe në mënyra të tjera përgjegjës për përdorimin nga ana Juaj të Njësisë së Shitjes RIME si dhe për cdo përdorim të llogarisë Suaj ose të informacionit të hyrjes nga të tjerët, duke përfshirë, pa kufizime, të miturit, dhe ju bini dakort të mbikqyrni të gjithë përdorimin e Njësisë së Shitjes RIME, në emrin dhe llogarinë Tuaj nga Përdoruesit e Autorizuar prej Jush.

**2.4** RIME rezervon të drejtën që të ndër marrë hapat që RIME në mënyrë të arsyeshme beson se janë të nevojshëm dhe të përshtatshëm për të zbatuar dhe/ose verifikuar pajtueshmërinë me cdo pjesë të këtyre Kushteve të Blerjes, duke përfshirë lehtësimin e pagesës së taksave të zbatueshme tek organet qeveritare ose tarifat për Shitësit e Ofertave, Ofertat e të cilëve Ju keni Blerë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në të drejtën e RIME për të bashkëpunuar në cdo proces ligjor në lidhje me përdorimin Tuaj të Ofertave dhe/ose ndonjë pretendim të palëve të treta që përdorimi nga ana Juaj i Ofertave është i paligjshëm dhe/ose shkel të drejtat e kësaj pale të tretë). Ju bini dakort që RIME ka të drejtën, pa pasur përgjegjësi ndaj Jush, për të përhapur cdo informacion rreth Jush tek autoritetet e taksave ose tek autoritetet e zbatimit të ligjit, nëpunësit qeveritarë dhe/ose tek ndonjë palë të tretë sic RIME beson në mënyrë të arsyeshme se është e nevojshme ose e përshtatshme për të zbatuar dhe/ose verifikuar pajtueshmërinë me cdo pjesë të këtyre Kushteve të Blerjes (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në të drejtën e RIME për të bashkëpunuar në cdo proces ligjor në lidhje me përdorimin Tuaj të Ofertave dhe/ose ndonjë pretendim të palëve të treta që përdorimi nga ana Juaj i Ofertave është i paligjshëm dhe/ose shkel të drejtat e kësaj pale të tretë).

### 3. CMIMI, TAKSAT, DHE KUSHTET E PAGESËS

3.1 Cmimet e pagueshme për Ofertat janë ato të treguara në konfirmimin e zbatueshëm të blerjes në ekran në momentin e Pranimit, dhe i nënshtrohen taksave të zbatueshme sic përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga RIME. Metoda Juaj e autorizuar e pagesës do të përfshijë cmimin dhe taksat në momentin e Pranimit të porosisë Suaj. JU JENI PËRGJEGJËS PËR PAGIMIN E KËTYRE SHUMAVE. Për të qenë të qartë, nuk ka kthim shumash në rast se cmimi ulet pasi Ju Blini një Ofertë ose nëse ka një ofertë promovionale të mëvonshme për një Ofertë që Ju keni Blerë. Në rast se Ju mendoni se metoda Juaj e autorizuar e pagesës është debituar ose ngarkuar në mënyrë të parregullt, Ju duhet të njoftoni shërbimin e klientit të Njesisë së Shitjes RIME brenda 30 ditëve nga Blerja, tek <https://www.blackberry.com/technicalsupport/index.do?ft=generic>.

3.2 Disa Oferta janë të ofruara në bazë regjistrimi që auto-rinovohet, gjë që synon që t'Ju kursejë kohë, përpjekje dhe rreziqe duke e shtyrë regjistrimin Tuaj automatikisht përpara se të skadojë. Duke blerë një Ofertë me regjistrim të auto-rinovueshëm, Ju bini dakort që regjistrimi Juaj mund të rinovohet për një afat shtesë të rinovuar, dhe Ju në mënyrë të shprehur autorizoni dhe lejoni RIME që të faturojë cdo tarifë për rinovimin e regjistrimit tek metoda Juaj e përzgjedhur e pagesës deri sa secili nga Ju vetë (ose për regjistrimet dhuratë, Ju ose marrësi i dhuratës) e fshini regjistrimin, ose RIME ndërpret rinovimin automatik dhe faturimin e regjistrimit. Për cdo Ofertë me regjistrim të auto-rinovueshëm që Ju blini, Juve do t'ju dërgohet të paktën një email në adresën email që Ju keni dhënë në lidhje me ID Tuaj BlackBerry për t'Ju kujtuar për një rinovim të pritshëm përpara se regjistrimi Juaj të rinovohet. Ju keni kontroll të plotë mbi regjistrimin Tuaj dhe mund të anuloni auto-rinovimin Tuaj në cdo kohë. Konfirmimi i porosisë Suaj dhe emaili i konfirmimit do të përfshijë udhëzime se si mund ta anuloni rinovimin automatik të regjistrimit Tuaj. Ju lutem kini parasysh se në rast se Ju ndërprisni regjistrimin Tuaj për një Ofertë të vecantë, Ju duhet të rinovoni në mënyrë manuale regjistrimin Tuaj për të parandaluar ndërprerjen e aksesit tek Oferta.

3.3 Të gjitha detyrimet për Blerjet do të faturohen tek metoda e pagesës që Ju keni përzgjedhur në Njësinë e Shitjes RIME të aplikueshme. Në rast se Ju dëshironi të ndryshoni mënyrën Tuaj të pagesës, Ju mund ta bëni në menunë e Opsioneve të Pagesës në Njësinë e Shitjes RIME.

### 4. KUSHTET E LICENSËS SË SHITËSIT

4.1 Si për shpërndarjet pa pagesë me anë të Njesisë së Shitjes RIME, titulli nuk kalon me anë të Blerjeve të Përmbajtjes ose me programet e Ofertave. Ju keni të drejtë të përdorni kopje të Përmbajtjes, duke iu nënshtuar dhe në përputhje me termat e cdo marrëveshjeje licensimi të përdoruesit fundor, me rregullat, ose me kushtet dhe modalitetet e tjera që përfshihen në Ofertë (“**Kushtet e Licensës së Shitësit**”). MLZBB përcakton kushtet që zbatohen kur nuk ka Kushte të Licensës së Shitësit. Disa Kushte të Licensës së Shitësit mund të përfshihen në rregullat për një shërbim të caktuar. Për shembull, në rast se Ju blini marrjen me qera të një filmi, mund të ketë kufizime kohore për kohën kur Ju duhet të filloni të shikoni filmin (për shembull brenda 30 ditëve nga Blerja) dhe, nga momenti që Ju filloni ta shikoni filmin, mund të ketë kufizime mbi kohën kur Ju duhet të mbaroni së shikuari atë (për shembull, brenda 24 orësh). Mund të ketë gjithashtu kufizime në lidhje me cilat modele të paisjeve ose në sa paisje të ndryshme Ju mund ta shikoni filmin. Ju njihni dhe bini dakort që aftësia Juaj për të aksesuar ose përdorur këto Oferta mund të përfundojë automatikisht, pa njoftim të mëtejshëm tek Ju, në përputhje me Kushtet e aplikueshme të Licensës së Shitësit.

### 5. RREZIQET DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

5.1 Përveç se kur përcaktohet ndryshe në këto Kushte të Blerjes, rreziku i humbjes apo dëmtimit të Ofertave të Njesisë së Shitjes RIME kalon nga RIME ose Shitësi i Ofertës tek Ju, me shkarkimin e saj. Si me shpërndarje të tjera të Ofertave, nga momenti që Ju shkarkoni ndonjë Ofertë, ajo kalon në përgjegjësinë Tuaj, dhe asnjë prej RIME ose degëve të saj, ose Shitësi i Ofertës, nuk është përgjegjës ndaj Jush për cdo humbje, shkatërrim ose dëmtim të këtyre materialeve. Ju duhet t'i ruani Ofertat Tuaja. Mbështetja Juaj në

Njësinë e shitjes RIME (“Bota Ime-My World”) Ju mundëson që të c’instaloni dhe ri-instaloni disa Programe dhe Njësi të Palëve të Treta në Paisjen Tuaj *Handheld* sic detajohet më tej në rregullat aktuale të momentit për *Botën Time*, të cilat mund të ndryshojnë nga koha në kohë.

## **6. POLITIKA RIME PËR RIKTHIMIN E SHUMAVE, MBËSHTETJA PËR NJËSINË E SHITJES RIME DHE MBËSHTETJA PËR PRODUKTET.**

6.1 Të gjitha Blerjet i nënshtrohen Politikës së Rikthimit të Shumave, e disponueshme tek <http://www.blackberry.com/legal/rime-store-refunds-policy>, sic azhurohet kohë pas kohe.

6.2 Ju lutem referohuni tek faqja internetit për Njësinë e Shitjes RIME të aplikueshme për shërbime mbështetëse që janë të disponueshme për Njësinë e Shitjes RIME dhe për çështje shkarkimi. Shitësit e Ofertës janë përgjegjës për garancitë dhe mbështetje për Ofertat e tyre.

6.3 PËRCAKTIMET E MLZBB NË LIDHJE ME NDONJË OFERTË, DUKE PËRFSHIRË ATO NË LIDHJE ME NJË LLOJ OFERTE TË TILLË SI PROGRAMI, SHËRBIMET RIM, NJËSI TË PALËVE TË TRETA, DHE SHËRBIME TË PALËVE TË TRETA ZBATOHEN PËR BLERJET OSE OFERTAT TUAJA, PA U KUFIZUAR NË SA NË VIJIM, LICENSA, PRIVATËSIA, EXPORTI, GARANCIA, MOSPRANIMET, PËRJASHTIMET, DHE KUFIZIMET E PËRGJEGJËSISË TË PËRCAKTUARA NË MLZBB APLIKOHEN NDAJ PROGRAMIT , SHËRBIMEVE RIM, NJËSIVE TË PALËVE TË TRETA, DHE SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA, NË NIVELIN NË TË LARTË TË LEJUESHËM NGA LIGJI I APLIKUESHËM, KUFIZIMET, PËRJASHTIMET DHE MOSPRANIMET NË MLZBB DO TË APLIKOHEN NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMIT RIME (DUKE PËRFSHIRË, PA U KUFIZUAR, OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME KRYERJEN E PAGESAVE).

## **7. AUTORIZIMET DHE DETYRIMET DOGANORE**

7.1 Ju mund të jeni objekt i, dhe përgjegjës për pagesat doganore dhe/ose tarifat e importit që ju ngrakohen kur Ju shkarkoni Ofertat. Cdo pagesë e tillë shtesë për zhdoganime ose tarifa doganore duhet të paguhet nga Ju. Ju duhet të kontaktoni zyrën lokale doganore në juridiksionin përkatës për informacion të mëtejshëm në lidhje me politikat ose tarifat e zbatueshme doganore.

7.2 Ju do të siguronit me shpenzimet Tuaja cdo licencë apo autorizim të ndonjë qeverie ose autoriteti tjetër që kërkohet për përfitimin ose përdorimin e Ofertave nga Ju dhe, nëse është e nevojshme, prodhoni evidencë ndaj RIME për këtë lloj kërkesë. Moskryerja e këtyre veprimeve nuk Ju jep të drejtë të mbani ose vononi pagesën për Ofertën. Cdo shpenzim ose pagesë shtesë të mbajtur nga RIME që vjen si rezultat i mosarritjes Tuaj për t’ju përmbajtur këtij Seksioni, do të paguhet nga Ju. Ofertat mund të jenë objekt i ligjeve dhe rregulloreve të kontrollit të përdorimit, importit dhe eksportit në territorin ose juridiksione të tjera të lidhura me të, ku Ju bëni dërgimin, eksportimin e Ofertave nga, importimin e Ofertave në, ose përdorni Ofertat. Ju jeni përgjegjës për pajtueshmërinë me ato ligje dhe rregullore dhe përfaqësoni e garantoni që Ju nuk do kryeni asnjë veprim për t’i shkelur ato. Ju bini dakord gjithashtu se Ju do të dëmshpërbleni plotësisht RIME dhe cdo ofrues të shërbimit RIME për mospërputhjen Tuaj me këtë seksion.

## **8. INFORMACIONI PERSONAL DHE PRIVATËSIA JUAJ**

8.1 Si shtesë të informacionit që Ju keni rënë dakord, sipas MLZBB, që RIME mund të Përpunojë për të kryer dhe dërguar Blerjet Tuaja, RIME mund të Përpunojë llogarinë Tuaj të metodës së pagesës dhe detaje të tjera si, numri i kartës së kreditit, adresa e faturuar, informacion për Ofruesit e Shërbimit Hapsinor, informacion për Ofertat e shkarkuara dhe të blera, dhe informacion për identifikuesin e pajisjes dhe detaje të tjera në lidhje me përdoruesin si, vendndodhja Juaj në kohën e Blerjes (“**Informacioni për Pagesën**”). Ju bini dakord që RIME mund të marrë një informacion të tillë direkt ose nga ofruesit e shërbimit, të cilët ofrojnë shërbime plotësuese shpërndarjeje dhe ndihmëse ndaj RIME, përpunues pagese si PayPal, shoqëri kartash krediti, ose, në rastin e një transaksioni *carrier-billed* ndaj të cilave aplikohen këto Kushte Blerjeje, Ofruesit e Shërbimit Tuaj Hapsinor, sipas aplikimit. Ju autorizoni RIME-n të ofrojë Informacion për Pagesën Tuaj ndaj palëve të treta MoRs, përpunuesit e pagesës, ose entitete të tjera pasi kërkohet në mënyrë të arsyeshme të lehtësohen shërbimet e Blerjes dhe ato ndihmëse. Në disa raste kur Ju keni furnizuar më parë një Palë të Tretë MoR me Informacion Tuaj të kartës së kreditit, Ju mund të pyeteni nëse kjo palë e tretë mund të ofrojë RIME me këtë informacion për t’u përdorur kur RIME vepron si MoR për Blerjet Tuaja. Nëse RIM merr këtë Informacion Pagese, ai do të përdoret në mënyrën e arsyeshme që kërkohet për të lehtësuar Blerjet Tuaja në përputhje me këto Kushte Blerjeje.

8.2 Informacioni personal që Përpunohet nga RIME dhe shoqëritë filiale të saj dhe ofruesit e shërbimit do të trajtohen në përputhje me Politikën e Privatësisë së RIM (e cila është inkomporuar këtu si referencë dhe mund të shihet te [www.blackberry.com/legal](http://www.blackberry.com/legal) ose mund të merret duke dërguar e-mail në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com))

Një Përpunim i tillë mund të përmbajë përmbushjen e shërbimeve ndihmëse dhe të dërgimit që kanë lidhje me Blerjet Tuaja, të tilla si, të dërgojë porosinë Tuaj, të marrë pagesën, t’ju njoftojë Ju në lidhje me statusin e porosisë Suaj, të lehtësojë azhurnimin ose rinovimin e abonimeve për Ofertat (nëse është e zbatueshme), të përmirësojë një Njësi Shitjeje RIME dhe t’ju sigurojë Ju me shërbimin e efektshëm ndaj klientit, të zbatojë kufizimet për lincësimin, të paguajë taksat e aplikueshme, të konfirmojë identitetin dhe të kryejë verifikime krediti, hetojë dhe parandalojë aktivitete mashtruese, dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulluese ose sic e lejon ligji. Informacioni për Pagesën mund të Përpunohet nga ose në emër të RIME brenda ose jashtë vendit në të cilin Ju ndodheni, duke përfshirë pa kufizim në Kanada, SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Singapor ose vende të tjera kur ka ambiente të operuara nga ose në emër të Grupit të Shoqërive RIM ose ofruesi i shërbimit të zbatueshëm. Nëse Ju jeni një rezident i Zonës Ekonomike Europiane ose i një vendi në të cilin kërkohet autorizim për të transferuar informacionin personal jashtë atij juridiksioni, Ju duhet të jepni autorizimin për këtë lloj Procesimi.

## 9. INFORMACION SHITESË

9.1 Informacion për kontaktimin dhe informacion shtesë për RIME mund të shihet në <http://www.blackberry.com/legal/rime>.